



BASHKIA SHKODËR

NJOFTIM PËR PUNËSIM

03/06/2021

Fondi Shqiptar i Zhvillimit në bashkëpunim me **Bashkinë Shkodër**, fillojnë zbatimin e projektit **“Punë për komunitetin”** në zonat me rrezikshmëri të lartë nga përmbytjet, me qëllim përmirësimin e gjendjes fizike dhe funksionin e kanaleve kulluese, si dhe të gjendjes ekonomike dhe sociale në komunitet, duke patur parasysh nivelin e papunësisë së shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Ky projekt do të zgjasë 4 muaj dhe mbështetet nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) nëpërmjet GIZ në Shqipëri. Për gjatë 4 muajve projekti do të punësojë një numër përfituesish në komunitet, të cilët do të punojnë kryesisht për pastrimin dhe sistemimin e kanaleve kulluese në zonat e ndikuara nga përmbytjet.

Nëse jeni të interesuar të ndihmoni komunitetin dhe vendbanimet tuaja, kundrejt një page mujore, ju lutemi të paraqiteni pranë zyrave me një ndalesë në Njësitë Administrative Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Velipojë, Rrethina, Postrinë dhe Gur i Zi deri në datën 13.06.2021, duke patur me vete një kopje të kartës së identitetit, adresën e banesës tuaj, numrin e llogarisë bankare dhe një numër kontakti.

Projekti inkurajon aplikimet nga grupet në nevojë dhe të grave nga këto komunitete.

Punë për Komunitetin